



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ELBASAN

KESHILLI BASHKIAK

KOMISIONI I FINANCEVE, BUXHETIT DHE ASETETEVE PUBLIKE

RAPORT VENDIMARRJE

Nr 18, Datë 19/12/2025

Lënda: Vendim për shqyrtimin e Projekt-vendimit nr.....datë,/...../2025, "Për miratimin e PBA 2026-2028, Buxhetin 2026, Bashkia Elbasan"

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Elbasan

Hyrje

Ky projekt-vendim paraqitet nga Drejtoria e Fiance Buxhetit, dhe ka për qëllim:

BAZUESHMERIA LIGJORE DHE VOTIMI	Hartimi i programit buxhetor afatmesëm 2065-2028, është bazuar në ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", si dhe udhëzimin no 23, dt 30.07.2018 per procedurat standarde te pergatitjes se PBA per njesive te vetqeverisjes vendore, të Ministrisë së Financave.
SITUATA AKTUALE E FUNKSIONIT	Objektivi i këtij Programi afatmesëm është përmirësimi në vazhdim i cilësisë së jetesës në qytetin e Elbasanit, nëpërmjet mbrojtjes së mjedisit, rritjes së sigurisë në rrugë e në objektet shkollore, përmirësimit të kushteve në çerdhe, kopështe e shkolla, ofrimit të shërbimeve sociale cilësore, rritjes së punësimit dhe zhvillimit të ekonomisë rurale, turizmit, etj. Parashikimi i të ardhurave e shpenzimeve është bazuar në Paketën fiskale të Bashkisë Elbasan, miratuar ne muajin Nentor 2025, Shpërndarjen e burimeve në përputhje me prioritetet e zhvillimit të qytetit, Prioritetet e qytetarëve të evidentuara gjatë takimeve në çdo lagje, apo njësi administrative. Shtyllat kryesore në të cilat është mbështetur hartimi i Programit buxhetor afatmesëm 2026-2028, janë, Zhvillimi ekonomik i qytetit dhe nxitja e punësimit, Garantimi i pastërtisë së qytetit dhe i cilësise së ajrit, Ofrimin e shërbimeve cilësore, Përmirësimin e infrastrukturës arsimore, Përmirësimin e infrastrukturës rrugore, Nxitjen dhe mbështetjen e aktiviteteve sportive, Gjallerimi i jetes kulturore e artistike dhe Mbeshtetje per trashegimine kulturore dhe zhvillimin e turizmit.
SITUATA FINANCIARE	<u>Plani i te ardhurave 2026-2028</u>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ELBASAN

KESHILLI BASHKIAK

KOMISIONI I FINANCEVE, BUXHETIT DHE ASETVE PUBLIKE

(Impakti financiar, shtesa pakësime në buxhet)	<i>Te ardhurat nga taksa dhe tarifat:</i> viti 2026 – 1,449,581 mije leke, 2027 – 1,478,570 mije leke, 2028 – 1,508,139 mije leke. <i>Te ardhura jo tatimore:</i> viti 2026 - 171,959 mije leke, 2027 - 175,398 mije leke, viti 2028 – 178,907 mije leke. <i>Te ardhura nga transfertat e pakushtezuar:</i> viti 2026 – 1,195,774 mije leke, 2027 – 1,296,668 mije leke, 2028 – 1,359,029 mije leke. <i>Transferta e pakushtezuar sektoriale:</i> viti 2026 – 655,800 mije leke, 2027 dhe 2028 do të jetë 762,128 mije leke. <u><i>Totali i te ardhurave:</i></u> viti 2026 – 3,624,916 mije leke, 2027 – 3,867,434 mije leke, 2028 – 3,965,795 mije leke <u><i>Plani i shpenzimeve:</i></u> <i>Shpenzime kapitale/investime</i> viti 2026 – 700,329 mije leke, 2027 – 784,383 mije leke, 2028 – 866,150 mije leke <i>Totali i shpenzimeve:</i> viti 2026 – 3,624,916 mije leke, 2027 – 3,867,434 mije leke, 2028 – 3,965,795 mije leke
DREJTORIA PËRGJEGJËSE	Drejtoria e Finance Buxhetit
RAPORTIMI DHE MONITORIMI	Administrata e Bashkisë do të bëjë raportimin për Keshillin Bashkiak sipas të gjithë kalendarit të përcaktuar në kuadrin ligjor.
IMPAKTI SOCIAL DHE GRUPET QË PREKEN	Në PBA 2026-2028 janë konsideruar dhe adresohen të gjitha ceshtjet sociale të komunitetit, veçanërisht për personat me aftësi të kufizuara, pensionistet, të pastrehët, njerezit e vetmuar si dhe grupet vulnerabel – komuniteti Rom dhe Egjiptian, etj.
KONSULTIMI PUBLIK	Konsultimet publike për PBA 2026-2028, Buxheti 2026 dhe Paketa fiskale 2026, janë zhvilluar në të gjitha fazat e planifikimit, prill-maj 2025, dhe tetor nëntor dhjetor 2025. Dokumentat e konsultimeve janë të regjistruara në regjistrin e projekteve për konsultim publik në web të bashkisë/Rubrika Keshilli Bashkiak.

Komisioni i Përhershëm i Financave, Buxhetit dhe Aseteve Publike, i mbledhur më datën 19/12/2025 pasi shqyrtoi projekt-vendimin “Për miratimin e PBA 2026-2028 dhe Buxheti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KESHILLI BASHKIAK

KOMISIONI I FINANCEVE, BUXHETIT DHE ASETVEVE PUBLIKE

2026. Bashkia Elbasan", relacionin dhe dokumentat shoqërues të tij, paraqitur nga Kryetari i Bashkisë

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Ti propozojë Këshillit Bashkiak:
 - a. Kalimin e projekt aktit në mbledhjen e këshillit për vlerësim të mëtejshëm për vlerësim dhe miratim.
 - b. Miratimin e projektaktit
 - c. Refuzimin e miratimit të Projektaktit
 - d. Ti kerkoje drejtorise perkatese informacion shtese per projektvendimin
 - e. Miratimin e projektaktit me ndryshimet si vijon:
 - Pika e projektvendimit të ndryshojë në "....."
 - Pika e projektvendimit të ndryshojë në "....."
 - Tabela e projektvendimit të ndryshojë në "....."
 - Paragrafi i projektvendimit të ndryshojë në "....."

Bashkëlidhur argumentat e Vendimarrjes dhe mendimi i pakicës i parqitur në procesverbalin e Komisionit

Kryetari i Komisionit: Shefqet Bullari

Nenkryetar i Komisionit: Doris Madhi

Sekretar i Komisionit:

Anetar i Komisionit: Bukurosh Stafa

Anetar i Komisionit: Ermira Urupi

Anetar i Komisionit: Imelda Sejdini

Anetar i Komisionit: Eugen Isaj

Elbasan, më: 19/12/2025